

B a n k a e S h q i p ë r i s ë

M A T E R I A L D I S K U T I M I

2005/2

INFLACIONI BAZË: MATJA DHE LIDHJA E TIJ ME AGREGATËT MONETARË

EVELINA ÇELIKU



PËRMBAJTJA

<i>Abstrakt</i>	5
<i>1. Inflacioni bazë: pjesë e inflacionit total</i>	6
<i>2. Metodrat e matjes së inflacionit bazë: disa kritere vlerësuese</i>	8
<i>3. Inflacioni bazë në Shqipëri</i>	15
<i>3.1. Përzgjedhja e metodës optimale</i>	15
<i>3.2. Përvoja e matjes së inflacionit bazë në Shqipëri</i>	17
<i>3.3. Rezultate të metodave të matjes së inflacionit bazë me shportën e re</i>	20
<i>4. Lidhja ndërmjet agregatëve monetarë dhe inflacionit bazë</i>	26
<i>5. Konkluzione</i>	29
<i>6. Literaturë</i>	31
<i>Shënime</i>	32

ABSTRAKT

Duke hasur vështirësi në parashikimin dhe mbajtjen nën kontroll të inflacionit total për periudha afatgjata, një pjesë e bankave qendrore në vende të ndryshme preferojnë, të kontrollojnë dhe të parashikojnë inflacionin bazë, si një kontribut më të drejtpërdrejtë të politikës monetare të ndjekur prej tyre. Këtë ato e bëjnë duke përjashtuar nga inflacioni total elementet me ndikim të përkohshëm në çmimet e konsumit, që në fakt janë relativisht më pak të lidhura me politikën monetare. Në material, pasi bëhet një parashtrim i disa kritereve teorike dhe praktike, ekonomike dhe statistikore, mbi efektshmërinë e matjes dhe të përdorimit të inflacionit bazë nga bankat qendrore dhe në veçanti nga Banka e Shqipërisë, sugjerohet metoda optimale e llogaritjes së tij në rastin tonë. Konkludohet se metoda e mesatareve të trimuara është ajo që na ofron matjen më të përshtatshme. Duke shkuar më tej, studimi teston këtë matje edhe me anë të lidhjes së inflacionit bazë me agregatët monetarë, duke hedhur bazat e parashikimit të tij në një të ardhme të afërt.

1. INFLACIONI BAZË: PJSË E INFLACIONIT TOTAL

Inflacioni dhe kategoritë e llogaritjes së tij, prej disa kohësh janë bërë objekt diskutimi në rrethet e ekonomistëve, të studiuesve dhe të politikëbërësve në bankat qendrore. E tëra kjo, jo vetëm në aspektin e arritjes së objektivave të qartë sasiorë për inflacionin, i cili sigurohet nëpërmjet qëndrueshmërisë relative të çmimeve të konsumit, por edhe në drejtim të rritjes së aftësisë së bankave qendrore për të parashikuar inflacionin. Duke hasur vështirësi në parashikimin dhe mbajtjen nën kontroll të inflacionit total për periudha afatgjata, një pjesë e bankave qendrore në vende të ndryshme preferojnë, të kontrollojnë dhe të parashikojnë inflacionin bazë, si një kontribut më të drejtpërdrejtë të politikës monetare të ndjekur prej tyre. Këtë ato e bëjnë duke përjashtuar nga inflacioni total elementet me ndikim të përkohshëm në çmimet e konsumit, që në fakt janë relativisht më pak të lidhura me politikën monetare.

Kombinimi i faktorëve jashtë politikës monetare, bën që inflacioni të marrë goditje, që shpesh shfaqen për periudha afatshkurtra. Lexueshmëria e indeksit të çmimeve vështirësohet dhe ai kthehet në një indikator “të keq” për autoritetin monetar, sepse deformon ecurinë e inflacionit për arsye të jashtme dhe të përkohshme. Pasja e një indikatori “të mirë” të ecurisë së çmimeve për periudha afatgjata, nënkupton në njëfarë mase, izolimin e shifrës së inflacionit nga ndikimet afatshkurtra.

Për periudha afatshkurtra, mund të ekzistojnë goditje që krijojnë shmangie të ecurisë së inflacionit nga tendenca historike. Kjo nuk do të thotë, se ngjarje të tilla duhet të lihen në hije, por pesha që u duhet dhënë në studimin e tendencave të inflacionit, nuk duhet të zmadhohet në mënyrë të panevojshme. Ndër fenomenet që shkaktojnë luhatje dhe tronditje të tendencës së çmimeve të konsumit përmenden:

- sezonaliteti, për grupe, nëngrupe apo produkte të veçanta të shportës së mallrave të konsumit;
- prania e mallrave apo e shërbimeve, çmimet e të cilave janë të administruara;

- prania e mallrave të konsumit, të cilët shpesh bëhen objekt i vendosjes së taksave (politika fiskale), që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ndikojnë në rritjen e inflacionit total;
- prania e ngjarjeve shock që lëkundin ekuilibrat makroekonomikë të një vendi, të tilla si fatkeqësi natyrore, lëvizje politiko-sociale etj..

Nuk është e vështirë që të eliminohet nga inflacioni prania e veçuar e elementeve të mësipërme, sidomos, për grupin e parë dhe të dytë të faktorëve. Metodot e përdorura janë mjaft të thjeshta dhe të aplikueshme, në rast se ekziston një bazë e detajuar të dhënash. Në fakt, problemi bëhet pak më i komplikuar, kur kërkojmë të vlerësojmë serinë e tendencës afatgjatë të inflacionit, duke përjashtuar nga inflacioni total ndikimin e kombinuar të faktorëve që shkaktojnë goditje të ky i fundit. Metodot kanë evoluuar, duke filluar që nga ato përjashtuese e deri tek ato ekonometrike. Të gjitha metodat vendosen përballë faktit se sa dhe si ato i përmbushin kriteret teorike dhe ato statistikore. Përmbushja e kriterëve, gjykohet në përputhje me kushtet konkrete të zbatimit të regjimeve të ndryshme të politikave monetare nga bankat qendrore. Në fund të fundit, metodat kanë për qëllim të identifikojnë përbërësen afatgjatë, e cila supozohet se është inflacioni i pastër monetar, por edhe përfaqësuese e prirjeve inflacioniste të agjentëve ekonomikë.

Nëse do të vendoseshim përballë regjimit të inflacionit të synuar, është i domosdoshëm, disponimi i një matësi të këtij inflacioni-tendencë. Kjo do të ndikonte në rritjen e efikasitetit të politikës monetare, gjë që do të thotë se reagimi ndaj çdo ndryshimi të faktuar të çmimeve, mund të çojë në mbivlerësime të efekteve krejtësisht kalimtare.

Nëse banka qendrore ndjek ecurinë e agregatëve monetarë, ajo interesohet në mënyrë më të veçantë për përbërësen afatgjatë në inflacion dhe për ekzistencën e një lidhjeje të qëndrueshme ndërmjet kërkesës për para dhe çmimeve.

Materiali në vijim, fillimisht, përpiqet të japë disa gjykime në lidhje me metodat që përdoren më shumë për matjen e inflacionit

bazë duke i vënë ato përballë kritereve të teorisë ekonomike dhe statistikore. Më pas, prezantohet inflacioni bazë në rastin e Shqipërisë duke argumentuar metodën e zgjedhur me shkallën e përmbushjes së kritereve kryesore ekonomike dhe statistikore. Është testuar fakti se, seria e gjeneruar e inflacionit bazë me metodën e përzgjedhur, është realisht e lidhur me faktorë monetarë dhe konkretisht me agregatët M1 dhe M3. Në një hap të mëtejshëm, analizohet lidhja shkak-pasojë ndërmjet inflacionit bazë dhe agregatëve monetarë. Studimi, sugjeron jo vetëm matjen më të përshtatshme të inflacionit bazë, por përpiqet të hedhë hapa edhe në drejtim të qartësimit të lidhjeve të tij me agregatët monetarë. Ky është një hap kryesor që i shërben parashikimit të inflacionit bazë, që siç e shpjeguar më sipër, jo vetëm përbën një pjesë të rëndësishme e inflacionit total, por mbi të gjitha, është ajo pjesë që shpjegon më mirë hapat që politika monetare ka hedhur dhe do të hedhë për të mbajtur nën kontroll këtë tregues.

2. METODAT E MATJES SË INFLACIONIT BAZË: DISA KRITERE VLERËSUESE

Metodat që mundësojnë veçimin e komponentëve të përhershëm nga ata kalimtarë dhe që evidentojnë përbërësen jociklike të inflacionit (inflacionin bazë apo inflacionin strukturor), janë pasuruar me elemente të reja të teknikave statistikore dhe ekonometrike. Ndonëse ato tentojnë drejt gjetjeve gjithnjë e më të sakta, përsëri, problemet në lidhje me shkallën e përmbushjes së kritereve të teorisë ekonomike, statistikore dhe të kodit të transparencës së bankës qendrore, janë evidente. Që të përmbushen kriteret e teorisë ekonomike do të thotë që në përgjithësi, inflacioni bazë duhet të jetë përfaqësues i inflacionit monetar apo i prirjes afatgjatë të inflacionit. Kriteret statistikore mbështeten në faktin që devijimet relative standarde të serisë së inflacionit bazë duhet të jenë sa më të ulëta, duke ruajtur një nivel të kënaqshëm shpjegueshmërie të inflacionit total nga inflacioni bazë. Transparenca ka të bëjë me shkallën e kuptueshmërisë së inflacionit bazë të rezultuar nga aplikimi i metodave të ndryshme. Sa më e kuptueshme është metoda, aq më transparente është banka qendrore në komunikimin e inflacionit bazë për publikun.

Përvoja e deritanishme në këtë fushë, grupon metodat si më poshtë:

- a) sheshuese (metoda e mesatareve lëvizëse);
- b) përjashtuese të disa përbërësve të shportës;
- c) VAR apo VAR strukturor (SVAR).

Kategoria e parë, konsiston në përdorimin e një numri të njëpasnjëshëm filtrash, duke filluar që nga ai i mesatare lëvizëse të thjeshtë, të ponderuar e më pas në filtrin e Kalman-it apo edhe në atë të Hodrick & Prescott, me anë të të cilëve arrihet një shpërbërje e tipit të Beveridge & Nelson. Në fund të kësaj procedure arrihet të gjendet prirja më e mirë e mundshme, e pastruar nga elemente të veprimit të përkohshëm, të rastësishëm etj.. Ajo është një matëse e mirë e zhvillimeve afatgjata në inflacion në varësi të faktorit kohë. Përparësia e kësaj metode qëndron në faktin se teknikat janë thjeshtësisht të aplikueshme.¹ Ato mbështeten në hipotezën se fenomeni që shqyrtohet, në rastin tonë inflacioni, ka një përbërëse të padiskutueshme të prirjes. Disavantazhi i kësaj kategorie teknikash qëndron në faktin se ato janë pak a shumë arbitrare dhe lidhen me shkallën e përshtatshmërisë së formës së filtrit që duhet përdorur. Në këtë mënyrë, kjo kategori metodash mund të mos përmbushë kriterin e teorisë ekonomike. Përsa kohë që nuk jemi të sigurt nëse ecuria e pjesës afatgjatë, është e përcaktuar nga një tendencë e pastër, nga përbërësja e rastit apo nga ndonjë proces i ndërmjetëm, zgjedhja e formës së filtrit mbetet arbitrare. Kjo kërkon një analizë të plotë të karakteristikave të ciklit, gjë që mund të arrihet me anë të disa treguesve paraprakë.² Shifrat e inflacionit që dalin nga aplikimi i kësaj kategorie metodash, nuk janë transparente dhe lehtësisht të kuptueshme nga publiku.

Kategoria e dytë, njihet si “metoda e peshave zero”. Ajo përjashton nga llogaritja e inflacionit artikujt më të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme si edhe artikujt, çmimet e të cilëve janë të administruara. Kështu për shembull, Blinder (1982), duke aplikuar metodën përjashtuese, lë jashtë llogaritjes apo shportës, energjinë, produktet agro-ushqimore si edhe interesat e kredive hipotekare. Ndërkohë që ekonomikisht, përjashtimi i artikujve të tillë është e vështirë të justifikohet, statistikisht, është prania e volatilitetit të

lartë (devijim standard i lartë) në kohë të çmimeve të artikujve të lartpërmendur, që justifikon më mirë përdorimin e një metode të tillë.

Gjithashtu, nëse në shportë bëjnë pjesë artikuj, çmimet e të cilëve janë objekt i ndryshimeve të komanduara (administruara), atëherë përjashtimi i përhershëm i këtyre artikujve nga shporta është më i mbështetur ekonomikisht. Kjo për faktin se, ndryshimi i çmimeve në këta artikuj që përcillet në shifrën që merr IÇK-ja, varet nga faktorë jashtë bankës qendrore. Megjithë problemet që paraqiten, inflacioni i rezultuar nga aplikimi i përjashtimit të përhershëm të disa artikujve nga shporta, është një informacion më transparent për publikun. Teknika e përdorur nga Bryan dhe Cechetti (1994, 1995), ngrihet mbi të njëjtin parim, por disi më të moderuar dhe më fleksibël. Autorët propozojnë të mos eliminojnë gjithmonë të njëjtët përbërës të shportës. Elementet që eliminohen duhet të jenë të vendosur në ekstremet e shpërndarjes së devijimeve të ponderuara të çmimeve të përbërësve të shportës. Kjo, metodë është përdorur për matjen e inflacionit bazë edhe në Shqipëri deri në dhjetor të vitit 2001 dhe është zbatuar për herë të parë nga Schiesser (1995). Përpjekjet për të rishikuar llogaritjen e inflacionit bazë kanë vijuar edhe pas prezantimit të shportës së re, e cila paraqitet me një strukturë të ndryshme nga shporta paraardhëse.³ Kjo metodë e supozon që shpërndarja e ndryshimit të ponderuar të çmimeve të elementeve të shportës, i bindet një ligji normal, hipotezë që jo gjithmonë përmbushet nga seritë e ndryshimeve të çmimeve të konsumit në shportë. Po kështu, një problem tjetër, i kësaj metode është se ajo nuk arrin të korrigohet nga korrelacioni që ekziston ndërmjet inflacionit dhe ciklit ekonomik, i cili mund të përfaqësohet nga prodhimi industrial. Për pasojë, kjo metodë vërtet përpiqet të përmbushë kriterin statistikor⁴, por është larg përmbushjes së kriterit të teorisë ekonomike. Gjithashtu, kjo është një metodë disi më e komplikuar se metoda e përjashtimit të përhershëm dhe për rrjedhojë, më pak transparente në komunikimin me publikun. Metoda të tilla si ajo e mesatares së trimuar, e medianës etj., janë ndër më të ndeshurat e këtij grup-metodash.

Kategoria e tretë, e metodave koordinon në një shkallë të kënaqshme kriteret e teorisë ekonomike me ato statistikore. Quah dhe Vahey,

1995, janë përpjekur të shpërbëjnë inflacionin në dy pjesë: njëra që i përgjigjet një inflacioni të qëndrueshëm për periudha afatgjata (inflacioni bazë) dhe tjetra që nuk neglizhon goditjet në inflacion dhe, që quhet inflacion për periudha afatshkurtra apo inflacion ciklik. Argumenti ekonomik për inflacionin bazë, pra afatgjatë, bazohet mbi faktin që kurba e Philipsit është plotësisht vertikale: inflacioni varet nga faktorë me natyrë monetare, ndërsa prodhimi varet nga faktorë realë. Kështu, arbitrazhi në periudha afatshkurtra ndërmjet inflacionit dhe rritjes ekonomike mbetet pothuaj kalimtar.

Seria e inflacionit bazë, gjenerohet nga aplikimi i një modeli strukturor (VAR), ku evidentohet lidhja për periudha afatgjata ndërmjet inflacionit dhe prodhimit. Në punimet e kësaj fushe, në përgjithësi merren në konsideratë seritë e prodhimit industrial dhe të inflacionit (Blanchard dhe Quah, 1989; Jacquinet, 1999; Wynne, 1999 etj.). Këto lloj metodash krijojnë mundësinë edhe të vlerësimit të kohëzgjatjes së arritjes së ekuilibrit për inflacionin, pas një “çrregullimi” të shkaktuar nga një goditjeje të jashtme. Kjo ndihmon bankën qendrore për të vlerësuar kohën gjatë së cilës politika monetare duhet të qëndrojë “neutrale”, për të mbajtur një inflacion bazë brenda kufijve të parashikuar.

Ndër kategoritë e shpjeguara më sipër, duket se e fundit është më e plota dhe më e bazuara ekonomikisht. Duke përfaqësuar një teknikë moderne, duket se ajo ka dhënë rezultatet më të mira në drejtim të gjetjes së përbërëses afatgjatë të serisë së inflacionit, në modele të zbatuara për Eurozonën, Anglinë, Francën, Gjermaninë, Perunë, Kilin etj.. Megjithatë, për vende ku shënjestrohet inflacioni bazë, duket se kjo metodë cënon transparencën në komunikimin me publikun për objektivin e inflacionit, për shkak të shkallës së vështirësisë si metodë.

Më poshtë le të përmbledhim në një tabelë⁵, forma origjinale e së cilëse është trajtuar nga Wynne, 1999, kriteret bazë që ndihmojnë në zgjedhjen më optimale të mënyrës së matjes së inflacionit bazë. Veç kriteve të përmendura më lart (teoria ekonomike & statistikore si edhe transparenca), në tabelë janë listuar edhe kriteret tjerë të cilat duhen marrë në konsideratë gjatë procesit të zgjedhjes së metodës apo metodave llogaritëse të inflacionit bazë.

Në përgjithësi, zgjedhja e metodës optimale, varet nga faktorë të ndryshëm si: nga sasia e të dhënave të disponueshme (llojet e treguesve); nga gjatësia kohore e tyre, nga lloji i objektivit që bankat qendrore kërkojnë të arrijnë; nga tendencat historike të ecurisë së inflacionit etj.. Le të shpjegojmë shkurtimisht secilin nga kriteret, për të gjykuar më pas se cili është më i përshtatshmi për t'u aplikuar në rastin e Shqipërisë.

Tabelë 1: Kriteret për vlerësimin e metodave.

Kriteret të metodave	Metodat shprehese (mesatare lëvizëse)	Metodat	Metoda e mesatares së trimuar dhe metoda e medianës	VAR
	1	2.1	2.2	3
A është i llogaritshëm në kohë reale?	I mundshëm	Po	Po	Po
A është i mundshëm për të bërë parashikime?	I mundshëm	Jo	Jo	Po
A mund të shtrihet pas në kohë seria?	Po (?)	Po	Po	Po
A është i kuptueshëm nga publiku?	Po (?)	Po	I mundshëm	Jo
A e ndryshon shumë historinë e të dhënave?	Mundet	Jo	Jo	Po
A është i bazuar mbi teorinë statistikore dhe ekonomike?	Baza statistikore - Po Baza ekonomike - Jo	Baza statistikore - Jo Baza ekonomike - Po (?)	Baza statistikore - Po Baza ekonomike - Po (?)	Baza ekonomike & ekonometrike - Po

A është i llogaritshëm në kohë reale? Jo rastësisht, ky lloj kriteri është listuar i pari, sepse bankës qendrore i duhet një matje e inflacionit bazë në kohën kur publikohet inflacioni total. Pothuajse të gjitha metodat e listuara e përmbushin atë. Disa prej teknikave sheshuese të propozuara nga Baxter dhe King (1995), nuk lejojnë llogaritjen në kohë reale të inflacionit bazë, për shkak të mosdisponimit të vrojttimeve fundore të periudhës së zgjedhur. Megjithatë, përsa kohë që inflacioni bazë është i llogaritshëm në kohë reale nëpërmjet filtrit të mirënjohur, Hodrick-Prezscott, atëherë gjykohet që, përgjithësisht, metodat sheshuese, mund ta përmbushin kënaqshëm këtë kriter, ndaj edhe është vënë cilësimi “i mundshëm” në prerjen përkatëse.

A është i mundshëm për të bërë parashikime? Kriteri i dytë, ka të bëjë me faktin nëse është e mundur që metodat e ofruara të kenë aftësi parashikuese. Ndër metodat e prezantuara më lart, vetëm VAR, e ofron një mundësi të tillë që në konceptimin e metodës. Një banke qendrore i intereson mjaft që në bazë të të dhënave mbi sektorin real të ekonomisë si edhe të agregatëve monetarë, të parashikojë inflacionin bazë, kur është siguruar prania e ekuilibrave makroekonomikë për periudha afatgjata. Por, ndërsa përmbushja e këtij kriteri arrihet kënaqshëm me VAR, metodat e tjera në përgjithësi nuk janë të afta të na sjellin parashikime të drejtpërdrejta. Duhet të aplikohen teknika shtesë parashikuese që mbi bazën e serive të arritura për inflacionin bazë, të bëhen ekstrapolime për periudhat e ardhshme. Megjithatë, përbërësja e prirjes e rezultuar nga metodat sheshuese, mund të japë parashikime të inflacionit bazë, që varen vetëm nga variabli kohë. Ndaj në prerjen përkatëse është vendosur cilësimi “i mundshëm”.⁶

A mund të shtrihet seria pas në kohë? Ky kriter ka të bëjë me aftësinë e metodave të ndryshme për të matur inflacionin bazë, pa përjashtuar mundësinë e rishikimit të serisë pas në kohë. Për arsye të ndryshme, seritë e llogaritura të inflacionit mund të rishihen. Kështu nëse shporta e konsumit rikompozohet, kjo do të bëjë të nevojshme edhe rishikimin e serisë së inflacionit përtej (pas) momentit të prezantimit të shportës së re. Për pasojë, edhe inflacioni bazë duhet të shtrihet pas në kohë. Në përgjithësi, të gjitha metodat arrijnë ta përmbushin këtë kriter. Megjithatë,

shkalla e marrjes në konsideratë e të dhënave të kaluara të serisë së inflacionit është disi e pjesshme në metodat sheshuese. Një pjesë e tyre, eliminojnë segmente të serive, për shkak të kërkesave të vetë teknikave sheshuese (mesataret lëvizëse), që shërbejnë për të nxjerrë në pah tendenca themelore të serisë së inflacionit. Sa më e madhe të jetë shkalla e eliminimit të pjesëve të serisë, aq më pak teknika matëse, përmbush kërkesën e shtrirjes në kohë të saj. Në pjesën më të madhe të rasteve, ndeshemi me metoda të interpolimit linear me anë të të cilave seritë e inflacionit bazë rishihen pas në kohë, duke 'mos humbur' kështu historinë e tyre. Në njëfarë mënyre, ato përditësohen duke iu përshtatur kushteve të reja metodike.

A është informacion i kuptueshëm dhe transparent për publikun? Ky kriter ka një rëndësi të veçantë për bankën qendrore. Ai nuk ka të bëjë as me aspektin statistikor, as edhe me atë llogaritës, por drejtpërdrejt me transparencën që një bankë qendrore duhet të ketë në komunikimin me publikun. Në momentin që një bankë qendrore e përcakton inflacionin bazë si pjesë të rëndësishme të komunikimit me publikun, është e domosdoshme që ky i fundit ta kuptojë këtë kategori si inflacion, burimi i të cilit është kryesisht monetar. Kjo kërkesë bëhet më rigoroze dhe e nevojshme, atëherë kur bankat qendrore shënjestrojnë inflacionin bazë. Duke qenë se regjimi i inflacionit të shënjestruar (IT), kërkon transparencë dhe shkallë të lartë të të kuptuarit nga publiku, është e domosdoshme që edhe matja që ofrohet për inflacionin bazë (nëse shënjestrohet apo edhe nëse publikohet rregullisht), të transmetojë infomacion të qartë dhe transparent tek publiku. Kjo kërkesë përmbushet nga teknikat më të thjeshta. Por sapo ato fillojnë të sofistikohen, shkalla e kuptueshmërisë ulet dhe treguesi i transparencës çënohet. Ashtu siç edhe trajtuam më lart, teknika që ofron VAR është praktikisht e pakuptueshme nga publiku, ndërkohë që edhe ato të mesatares së trimuar, duke kërkuar plotësimin e disa kushteve statistikore, vështirësojnë kuptueshmërinë. Megjithatë, mundësitë që kjo teknikë të bëhet e kuptueshme, janë më të mira se sa metodat ekonometrike të VAR.

A e ndryshon shumë historinë e të dhënave? Është një kriter që lidhet me atë paraardhës. Nëse inflacioni bazë do të përdoret

nga banka qendrore në komunikimin e gjerë me publikun, është gjithashtu e rëndësishme që historia e të dhënave të mos ndryshojë në mënyrë të dukshme, sapo në seri hyn një vlerë e re e inflacionit. Nëse kjo do të ndodhte, besueshmëria e shifrës së inflacionit bazë, të shpallur nga banka qendrore do të vihej në pikëpyetje, gjë që dëmton reputacionin e bankës qendrore dhe të politikës monetare që ajo zbaton. Në fakt teknikat ekonometrike, sapo në seri hyn një vlerë e re, rishikojnë gjithë vlerat paraardhëse. Nëse saktësia e metodës ekonometrike është e lartë, pra gabimi është i vogël, ndryshimet nuk do të ishin shumë të mëdha, në të kundërt situata e besueshmërisë do të ishte krejt e ndryshme. Një problem të tillë, nuk e kanë teknikat e ofruara nga mesataret e trimuara dhe ato që përjashtojnë në mënyrë sistematike të njëjtat elemente nga shporta e konsumit.

A është i bazuar mbi teorinë statistikore dhe ekonomike? Gjatë parashtrimit të metodave theksuam se jo të gjitha përmbushin kënaqshëm kriteret e teorisë ekonomike dhe të asaj statistikore. Ndër metodat e prezantuara në mënyrë më të plotë këto kriteret plotësohen nga grupi i analizave të VAR: pra arrihet një seri e inflacionit bazë, e cila ka kufizimet më të pakëta në drejtim të metodologjisë së zgjedhur dhe të kuptimit ekonomik që përfaqëson. Megjithatë, mosplotësimi i kriterit të kuptueshmërisë dhe të transparencës nga publiku, është një kufizim i konsiderueshëm për aplikimin e metodave të tilla empirike. Metodot e tjera, paraqiten me kufizime që rrjedhin kryesisht nga mungesat në aspektin e teorisë ekonomike.

3. INFLACIONI BAZË NË SHQIPËRI

3.1. PËRZGJEDHJA E METODËS OPTIMALE

Në bazë të kriterëve të mësipërme, le të gjykojmë mbi zgjedhjen e metodës optimale për llogaritjen e inflacionit bazë, për kushtet e Shqipërisë.

Ndonëse grupi i fundit i metodave (VAR) mund të duket teorikisht më i ploti, përdorimi i metodave të tjera, në evidentimin e inflacionit

bazë, mbetet ende i preferueshëm për një pjesë të mirë të bankave qendrore. Kjo preferencë lidhet kryesisht me shkallën më të lartë të transparencës që kanë metodat e tjera. Nga ana tjetër, aplikimi i metodave të VAR, kërkon plotësi në lloje dhe në kohë të disa variablave ekonomikë. Në një pjesë të ekonomive, në veçanti në rastin e Shqipërisë, kjo kërkesë është e vështirë të plotësohet. Të dhënat shpesh mungojnë, arrijnë me vonesë kohore, janë vlerësime, përmbajnë pasaktësi dhe mbi të gjitha janë të shtrira për periudha, relativisht jo të mjaftueshme të shkurtra kohore. Kjo bën që aplikimi i VAR për vlerësimin e inflacionit bazë në Shqipëri, të jetë ende një proces në testim.

Metodat e kategorisë së parë apo ato që lidhen me teknikat sheshuese (kolona e parë e tabëlës 1), shërbejnë për të nxjerrë në pah prirjen e serisë së inflacionit në varësi të faktorit kohë. Megjithatë, kjo nuk nënkupton, se prirja e gjetur është pamja më e plotë e inflacionit bazë. Arbitrariteti në zgjedhjen e filtrave përbën kufizimin teorik më serioz, që së bashku me mosplotësimin e disa kriterëve apo shkallën e lartë të dyshimit në disa të tjera (shih tabelën 1), e kufizon mjaft përdorimin e kësaj metode në përgjithësi, dhe në veçanti në rastin e Shqipërisë.

Metodat e ofruara nga njëra anë, shkalla e përmbushjes së kriterëve nga ana tjetër, tregojnë se matja e inflacionit bazë në rastin tonë, mundësohet në mënyrë më optimale, nëpërmjet kategorisë së dytë të metodave, që në thelb kanë përjashtimin nga shporta të artikujve të ndryshëm. Duke iu referuar tabelës 1, këto metoda lidhen me kolonën 2.1 dhe 2.2 të saj.

Argumentet e përzgjedhjes së këtyre metodave lidhen: së pari me, plotësimin e kriterit të kuptueshmërisë dhe të transparencës, që informacioni mbi inflacionin bazë transmeton në publik; së dyti, ekziston baza e nevojshme e të dhënave për matjen e tij në kohë reale; së treti, është e mundur të rishikohet pas në kohë seria e inflacionit; së katërti, nuk ndryshon serinë tashmë të llogaritur të të dhënave, vetëm e shton atë me vlerat e reja të llogaritura të muajve dhe të periudhave që vijnë pas; së pesti, plotësimi i kriterëve ekonomike dhe statistikore paraqitet i pjesshëm. Llogaritja e inflacioni bazë, pas përjashtimit të mallrave çmimet e të cilëve janë të administruara

(metoda që i referohet kolonës 2.1), është ekonomikisht dhe deridiku statistikisht, e bazuar. Kjo sepse lëvizjet në çmimet përkatëse nuk varen nga politika monetare që pasqyrohet tek inflacioni bazë, por nga politika e administruar e çmimeve që është faktor jashtë bankës qendrore. Kështu, inflacioni zhvishet nga goditjet e jashtme që në mënyrë “artificiale” krijojnë devijime të larta standarde. Po kështu, përjashtimi i artikujve që paraqesin luhatshmëri më të lartë të ndryshimeve të çmimeve (metoda e mesatareve të trimuara që i referohet kolonës 2.2), është gjithashtu i mbështetur nga pikëpamja statistikore. Siç u përmend më lart dhe siç do të trajtohet hollësisht më poshtë, plotësimi i njëkohshëm i kriterëve statistikore, është parakusht për aplikimin e kësaj metode. Bazimi ekonomik është më i shprehur në rastet kur bëhen lëvizje në çmime, si pasojë e aplikimit të tarifave të administruara për mallra të ndryshëm, sepse artikuj të tillë vetërenditen brenda kufijve përjashtues. Kjo bën që ata të eliminohen nga llogaritja e inflacionit bazë, së bashku me mallrat e tjerë me volatilitet të lartë në ndryshimin e çmimeve. Po kështu ndodh edhe në rastet kur për mallra të ndryshëm aplikohen taksa (ulje apo ngritje), që pak a shumë reflektohen në çmime. Edhe kjo lëvizje e çmimeve nuk lidhet drejtpërdrejt me politikën monetare, por më shumë me reformat fiskale.

Nga analiza e mësipërme metoda e mesatares së trimuar, duket se konkludon në një seri inflacioni bazë më përfaqësuese për rastin e Shqipërisë. Kjo për faktin se një metodë e tillë, kombinon përjashtimin e njëkohshëm të efekteve që rrjedhin nga inflacioni apo deflacioni “sezonal”, nga inflacioni “i administruar” apo nga inflacioni si pasojë e goditjeve të tjera të jashtme.

3.2. PËRVOJA E MATJES SË INFLACIONIT BAZË NË SHQIPËRI

Metodologjia e llogaritjes së inflacionit bazë në Shqipëri është prezantuar nga McNeilly dhe Schiesser, në vitin 1998. Bazuar në këtë metodologji, inflacioni bazë vijoi të llogaritej, të raportohej dhe të analizohej deri në fund të vitit 2001, periudhë që përkoj me prezantimin e shportës së re. Dhjetori i vitit 2001, dëshmoi për një profil të ri të konsumit shqiptar, fakt që bëri të domosdoshëm rishikimin e serisë së inflacionit bazë. Duke studiuar serinë e

inflacionit nga viti 1993 deri në vitin 1995, Schiesser, provoi disa metoda për përzgjedhjen e më optimale në rastin e Shqipërisë, nisur nga disa kritere të rëndësishme statistikore. Kështu, u prezantuan kategori të inflacionit bazë duke:

- a – e zhveshur serinë e inflacionit total nga ndikimet sezonale, hap që justifikohet me praninë e dukshme të mallrave ushqimorë në shportën e konsumit (rreth 72 për qind);
- b – aplikuar metodën e mesatareve të trimuara për: 12.5; 25; 50; 75 dhe 87.5 apo në përgjithësi për (x) për qind të artikujve të shportës⁷. Me anë të kësaj metode, arrihet një përjashtim i efektit të kombinuar të faktorëve sezonalë, administrativë dhe të faktorëve të tjerë, që shkaktonin lëkundje të theksuara dhe të përkohshme në inflacion. Në çdo rast, krijohej një nënshportë që shërbente për llogaritjen e inflacionit bazë mbi artikujt e vendosur në qendër të shpërndarjes së devijimeve të ponderuara të çmimeve, të renditura këto në rendin rritës, pasi prej shportës përjashtoheshin në të dyja ekstremet $(x/2)$ për qind e artikujve (për më shumë detaje, shih McNeilly dhe Schiesser, 1998, faqe 27- 34).

Kriteret statistikore në përzgjedhjen e metodës optimale, lidhen me tregues që flasin për shkallën e luhatshmërisë së vlerave të inflacionit bazë. Le t'i shpjegojmë ata shkurtimisht:

- së pari, inflacioni bazë kërkon pasjen e një volatiliteti të ulët: ai nuk duhet të luhetet pranë kufijve që luhetet inflacioni total. Në gjuhën e statistikës, devijimi relativ apo koeficienti i variancës (devijim standard/mesatare) duhet të jetë sa më i ulët, madje më i ulëti i mundshëm ndër të gjitha matjet e rezultuara të inflacionit bazë;
- së dyti, inflacioni bazë kërkon pasjen e një korrelacioni linear të lartë me serinë e inflacionit total. Përmeshja e këtij kriteri, bën që në llogaritjen e inflacionit bazë, të mos përfshihen artikujt, çmimet e të cilëve janë mjaft të ndryshueshëm për periudha tranzitore dhe që për më tepër, nuk shkojnë në të njëjtin drejtim si prirja afatgjatë e inflacionit total. Nëse arrihet në një koeficient linear korrelacioni të fortësisë së kënaqshme apo mbi mesatare, do të thotë që seria e inflacionit bazë mund të shërbejë për një parashikim të mirë për inflacionin në periudhat e ardhshme.

Të dyja këto kritere kanë një marrëdhënie midis tyre. Ndërsa nga njëra anë përjashtimi gjithnjë e më i madh do të çonte në koeficientë variance gjithnjë e më të ulët, nga ana tjetër ky përjashtim do të ulte ndjeshëm lidhjen ndërmjet dy serive të inflacionit (bazë dhe atij total). Prandaj, plotësimi i njëkohshëm i të dyja kritereve, hyn në një proces optimizimi, ku gjykimi i studiuesit është mjaft i rëndësishëm.

Kështu, në rastin e Schiesser, megjithëse koeficienti linear i korrelacionit rezultoi më i lartë për serinë e inflacionit të pastruar nga ndikimet sezonale, kjo seri nuk u konsiderua e përshtatshme për matjen e inflacionit bazë, sepse koeficienti i variancës rezultoi më i larti ndër matjet e kryera. Po kështu, ndër dy mesataret e trimuara (12.5 dhe 25 për qind), koeficient më të ulët të variancës regjistroi matja që merrte për bazë vetëm 75 për qind të artikujve të shportës. Ndonëse, koeficienti i korrelacionit ishte paksa më i ulët se sa mesatarja tjetër e trimuar (12.5), ai përsëri rezultoi i lartë, rreth 0.73, kundrejt 0.81, (shih McNeilly & Schiesser, 98, Tab. 9). Nga analiza e rezultateve të variancës dhe asaj korrelative, u konkludua se përfaqja më e përshtatshme e kategorive të inflacionit bazë në rastin e Shqipërisë, ishte ajo që merrte për bazë 75 për qind të mallrave të vendosur në qendër të shpërndarjes së ndryshimeve të indekseve individuale të mallrave dhe të shërbimeve, të ponderuara me peshat apo me vendin që ato zënë në shportë. Pra, nga të dyja skajet e shpërndarjes së artikujve në shportë, përjashtoheshin përkatësisht 25/2 apo 12.5 për qind të tyre.

Ndonëse prezantimi i shportës së re sollti një informacion të ri, që fliste për ndryshime strukturore jo të pakta në mënyrën e të konsumuarit të një familjeje mesatare në Shqipëri nga viti 1993 në vitin 2001, përsëri mund të vërejmë se:

- efekti sezonal është ende në masë të konsiderueshme, megjithëse më i zbutur, për shkak të peshës më të ulët që zë grupi i artikujve ushqimorë në shportën e re. Në momente të caktuara të vitit, si në periudhën maj-gusht dhe në dhjetorët 1999-2003, efekti sezonal, sidomos për nëngrupet e frutave dhe të zarzavateve është mjaft i ndjeshëm;
- shporta e re, është e përbërë në pjesën më të madhe nga mallra dhe shërbime me çmime të liberalizuara, megjithatë,

prania e artikujve me çmime të administruara, mund të trondisë përkohësisht inflacionin total, për shkak të ndërhyrjeve të herëpashershme në rishikimin e tarifave dhe të çmimeve të ndryshme. Kjo ndërhyrje nuk ka të bëjë me politikën monetare dhe si e tillë duhet përjashtuar. Konkretisht, bëhet fjalë për çmimin e energjisë elektrike dhe të ujit;

- prania në shportë e mallrave që janë relativisht më të prekur nga reformat fiskale, shkakton luhatje të inflacionit;
- prania e ngjarjeve të tjera (zgjedhje, fushata, periudha të tensionuara politike), që nuk lidhen me politikën monetare, gjithashtu mund të shkaktojë tronditje të përkohshme ndaj pritshmërive për të ardhmen në inflacion. Kjo konsideratë, mendojmë se ndonëse është mjaft e zbutur për periudhat që kalojmë, përsëri nuk duhet neglizhuar.

3.3. REZULTATE TË METODAVE TË MATJES SË INFLACIONIT BAZË ME SHPORTËN E RE

Analiza dhe përpjekjet për ndërtimin e kategorisë së inflacionit bazë, janë kryer mbi të dhënat e shportës së re. Matjet për inflacionin bazë janë aplikuar për periudhën janar 1998 – maj 2004, duke iu referuar kështu një periudhe relativisht të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për inflacionin.


Përpjekja e parë, për matjen e inflacionit bazë me shportën e re u krye mbi një seri njëvjeçare të të dhënave, jo plotësisht të detajuara të indeksit të çmimeve të konsumit. Periudha, pothuajse 6-vjeçare, e serisë së IÇK, pa dyshim që përbën një bazë të dhënash më të plotë për të gjykuar mbi variantin dhe mbi metodën më optimale të matjes së inflacionit bazë. Nga ana tjetër, në këto matje janë reflektuar edhe përmirësimet e kryera nga INSTAT, në shportën e konsumit (tetor 2003)⁸.

Po kështu, vlerësohet se seria e IÇK, shtrihet në një periudhë të qëndrueshme të situatës së përgjithshme makroekonomike në vend. Ky vlerësim, na çon drejt gjykimit se, goditjet në serinë e inflacionit për shkaqe të tjera, jashtë politikës monetare, mund të jenë më të pakta. Kjo ndikon jo vetëm në një vlerësim më të saktë të inflacionit bazë, por edhe në procesin e parashikimit të tij.


Nga arsyetimet mbi kriteret e përzgjedhjes së metodës optimale të matjes së inflacionit bazë në Shqipëri, u gjykua se është grupi i dytë i metodave që i përshatet më mirë kushteve të tona. Për të parë se deri në ç’masë do të bëhet përjashtimi i artikujve nga shporta, u kryen disa llogaritje. Rezultatet mbi kriteret statistikore të koeficientit të variancës dhe të koeficientit linear të korrelacionit, na orientuan për matjen më optimale. Përveç grupit të dytë të metodave, u aplikua edhe pastrimi sezonal i serisë së inflacionit, për të gjykuar vetëm mbi ndikimin e veçuar të tij në inflacionin total. U krahasuan këto rezultate për seritë e inflacionit që dolën pas:

- A) pastrimit të serisë së inflacionit total nga ndikimet sezonale;
- B) përjashtimit nga shporta, të mallrave dhe të shërbimeve, çmimet e të cilëve janë të administruara;
- C) zbatimit të metodës së mesatares së trimuar: për 75, 70, 60 dhe 50 për qind të artikujve të shportës.

Nga zhveshja e serisë nga ndikimet sezonale rezultoi një seri me zbutje të theksuara që shprehen në një koeficient të ulët të variancës. Nga ana tjetër, rezultoi një koeficient linear i korrelacionit i ulët ndërmjet serisë së inflacionit total dhe asaj të zhveshur nga ndikimet sezonale. Kjo mbështet idenë se, ndikimet sezonale janë një faktor i rëndësishëm shpjegues për ndryshimet në IÇK.



Përjashtimi sistematik i të njëjtëve artikuj nga shporta e konsumit u bë për energjinë dhe për ujin. Baza teorike e këtij aplikimi ka të bëjë me faktin që ndryshimet në këto çmime janë të administruara dhe lidhen me reformat e ndërmarra në drejtim të liberalizimit të çmimeve si hapa parapërgatitorë në privatizimin e sektorëve përkatës. Inflacioni i matur në këtë mënyrë, rezultojn me një koeficient më të lartë variance se matjet e tjera, sepse kjo matje përjashton vetëm një efekt që deri-diku rezultojn i veçuar në kohë, ndërsa efektet e tjera mbeten. Koeficienti linear i korrelacionit rezultojn i lartë. Kjo ka ardhur nga fakti se ndryshimet në çmimet e energjisë dhe të ujit, janë në pjesën më madhe njëherëshe. Po kështu, ato zënë pesha relativisht të ulëta në shportën e konsumit. Grafiku 2, tregon qartë që dy trajektorët e inflacionit (total dhe bazë) janë mjaft pranë njëra-tjetrës, madje për muajt të tërë kanë qenë pothuaj të përputhura. Lëvizja e tyre është gjatë gjithë kohës në të njëjtin drejtim .



Për periudhën janar 2002 – maj 2004, shihen dy pika ‘kritike’ për inflacionin, ku aplikimi i tarifave të rritura në cmimin e energjisë elektrike, ndikoi ndjeshëm në inflacion: qershor – gusht 2002 dhe shkurt 2004.

Aplikimi i mesatares së trimuar, ka konsistuar në një seri provash për gjetjen e nënshportës më të përshtatshme për matjen

e inflacionit bazë, në bazë të kriterëve statistikore, tashmë të sqaruara më sipër. Në çdo muaj, përjashtohen artikujt që kanë paraqitur luhatshmërinë më të lartë dhe që mund të kenë ndikuar në rritjen apo edhe në uljen e inflacionit. Artikujt e përjashtuar, mund të përbëjnë 17, 25, 30 dhe 50 për qind të elementeve të shportës. Më pas normalizohen peshat, në mënyrë që totali i tyre në nënshportat e reja të rezultojë 100 për qind. Janë këto peshat të reja që ponderojnë indekset individuale të artikujve të mbetur në shportë. Shuma e tyre është indeksi bazë i çmimeve, që shërben për matjen e inflacionit bazë (muajor dhe vjetor). Në bazë të provave gjykohet se cila prej nënshportave mund të japë informacionin më të mirë për inflacionin bazë.

Nga studimi paraprak (korrik 2003), u konkludua se një matje e mirë e inflacionit bazë bëhet atëhere kur, nga shporta eliminohen rreth 12.5 për qind e artikujve të vendosur në çdo skaj të shpërndarjes së devijimeve të çmimeve përkatëse të tyre. Pra, inflacioni bazë matej mbi bazën e informacionit që sillnin për çmimet vetëm 75 për qind e artikujve të shportës, devijimet e ponderuara të çmimeve të të cilëve janë vendosur në qendër të shpërndarjes së tyre.


Siç edhe u trajtua në fillim të këtij nënseksioni, studimi i mëtejshëm i përbërjes së shportës së mallrave, detajimi i saj, informacioni i ri mbi rentën e imputuar, disponimi i serive më të gjata kohore të IÇK-së së detajuar, ndihmuan në kryerjen e një analize më të plotë të kriterëve statistikore, duke konkluduar se: matja që jep informacionin më cilësor për inflacionin bazë është ajo që merr parasysh vetëm 70 për qind të artikujve të shportës, pra që eliminon 30 për qind të tyre (15 për qind për secilin skaj). Kjo matje ka koeficientin më të ulët të variancës, që flet për një seri me volatilitet relativ të ulët si edhe koeficientin më të lartë të korrelacionit me inflacionin total.

Tabelë 2: Kriteret statistikore sipas metodave.


Kriteret	Inflacioni total	Inflacioni pa sezonalitet	Inflacioni pa energji & ujë	Mesatare e trimuar		
				Inf - 30	Inf - 40	Inf - 50
1. Koeficienti i variancës	6.71	3.51	6.66	4.66*	6.13	17.86
2. Koeficienti linear i korrelacionit	1	0.36	0.97	0.65*	0.60	0.38

Grafik 3. Inflacioni bazë sipas mesatareve të trimuara dhe inflacioni total.


a.



b.




c.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 4. Norma mujore e inflacionit bazë (-30 për qind),
janar '98 – dhjetor '2005.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nëse kriteret e teorisë ekonomike dhe të asaj statistikore respektohen relativisht mirë, atëherë pritet që për periudha afatgjata, mesatarja e serisë së inflacionit bazë të konvergojë drejt mesatares së serisë së inflacionit total. Matjet e deritanishme, dëshmojnë se norma mujore e inflacionit bazë në nivel mesatar, po tenton gjithnjë e më shumë drejt asaj të inflacionit total.

Grafik 5. Norma vjetore e inflacionit bazë (30 %) dhe
e inflacionit total (janar '99 –dhjetor '05).



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Në nivel vjetor, duket se prirja e inflacionit bazë ka qenë e qëndrueshme, gjë që tregon se faktorët që lidhen me politikën

monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë, kanë qenë nën kontroll të vijueshëm, për të mos shkaktuar presione inflacioniste. Në të kundërt, prania e faktorëve të tjerë, jashtë politikës monetare, ka bërë që norma vjetore e inflacionit total të shfaqë një trend të lehtë rritës gjatë periudhës referuese (Grafik 5).

Ndonëse metodat kanë kufizimet e tyre, gjykohet se përfundimet e analizës së variancës dhe ato korrelative, mbështesin idenë se matja optimale e inflacionit bazë është ajo që aplikohet nga metoda e mesatares së trimuar me përjashtimin e 30 për qind të artikujve të shportës. Duket që një matje e tillë ndihmon edhe parashikimin e inflacionit, përsa kohë që ekziston një lidhje relativisht e fortë ($r=0.65$) ndërmjet inflacionit bazë dhe atij total.

Nëse sigurohet një parashikim për inflacionin bazë nëpërmjet agregatëve monetarë dhe faktorëve të tjerë ekonomikë, atëherë për një periudhë të ardhshme, mbetet e hapur mundësia e parashikimit të inflacionit total nëpërmjet statistikave të rezultuara më lart.

4. LIDHJA NDËRMJET AGREGATËVE MONETARË DHE INFLACIONIT BAZË

Duke testuar më tej matjen e gjetur më lart, arrijmë në përfundimin se kjo seri e inflacionit bazë (30 për qind), është më fort e lidhur me agregatët monetarë se sa seria e inflacionit total. Për më tepër, një matje e tillë tregon se rreth 43 për qind e ndryshimeve në inflacionin total, lidhen në mënyrë pozitive me ndryshimet në inflacionin bazë, tregues ky interesant për të mbështetur edhe parashikimin e inflacionit. Siç u trajtua në seksionin e parë të këtij materiali, ideja e adoptimit të regjimit të inflacionit të shënjestruar, është e lidhur ngushtë, nga njëra anë, me aftësinë e autoritetit monetar për të parashikuar ecurinë e inflacionit bazë në mënyrë që të mbahet një qëndrim i qartë i politikës monetare dhe nga ana tjetër, me matjen e efektit që, agregatët e ndryshëm monetarë mund të kenë mbi inflacionin bazë.

Le të provojmë, fillimisht, të identifikojmë se cila nga dy llojet e normave të inflacionit (total apo bazë) është më shumë e ndikuar

nga dy agregatët monetarë, M1 dhe M3. Kjo realizohet në një hap të parë duke analizuar koeficientët e përcaktueshmërisë. Jemi munduar t'i japim përgjigje pyetjes se cila nga matjet e inflacionit është më fort e lidhur me agregatët monetarë. Për të analizuar këto lidhje jemi mbështetur edhe në përfundime empirike të studimeve të paraprake (Kolasi, Çeliku 2002), (parashikimet e inflacionit në raportet mujore të zhvillimeve monetare, Banka e Shqipërisë), në të cilat konkludohet që agregatët monetarë ndikojnë mbi inflacionin me një vonesë kohore 3-6 muaj. Në vijim janë ndërtuar disa regrese, të bazuara mbi një formë të përgjithshme ekuacioni (shih ekuacionin 1). Këto regrese janë ndërtuar mbi skenarë të ndryshëm të normave mesatare të inflacionit, të treguara nga indeksi K. Për të dyja llojet e normave të inflacionit mujor (total dhe bazë), dhe për katër variantet e K, janë përfutur tetë ekuacione, ku është marrë në konsideratë, vlera e koeficientit të përcaktueshmërisë.

$$\Pi_t^K = \alpha + \sum_{i=0..6} B_i m_{t-i} + \varepsilon_t \quad (1)$$

ku: Π_t^K - inflacioni mesatar në kohën t për K muajt e ardhshëm⁹;
 m_{t-i} - norma e rritjes së agregatit monetar për një periudhë t-i;
 K - merr vlerat: 6, 12, 18 dhe 24 muaj.

Në tabelën 3 jepen koeficientët e përcaktueshmërisë për të gjitha rastet e ekuacioneve të regresit, ku për normën e rritjes së agregatëve monetarë është përdorur një vonesë, prej gjashtë muajsh.

Tabelë 3: Koeficientët e përcaktueshmërisë R^2 ndërmjet llojeve të inflacionit dhe rritjes së agregatëve monetarë*.

(K)	Norma e inflacionit total		Norma e inflacionit bazë**
	M=M1		
6	0.11		0.30
12	0.41		0.52
18	0.25		0.47
24	0.14		0.68
	M=M3		
6	0.24		0.06
12	0.02		0.04
18	0.07		0.22
24	0.01		0.17

Shënim: *Të dhënat përfshijnë periudhën janar 1998- dhjetor 2004.

**Norma mujore e inflacionit bazë sipas metodës së mesatares së trimuar, duke përjashtuar 30 për qind të artikujve.

Del në pah se është inflacioni bazë, i cili, është më i lidhur me agregatët monetarë. Po kështu, në pjesën më të madhe të rasteve është agregati M1, që dëshmon për një shkallë shpjegueshmërie relativisht të kënaqshme për normën e inflacionit bazë. Një konstatim i mëtejshëm do të bëhej për horizontin kohor të kësaj lidhjeje: shpjegueshmëria rritet, kur edhe horizonti kohor i mesatarizimit të normës së inflacionit rritet mbi 12 muaj. Ky përfundim plotëson kriterin teorik të ekzistencës së inflacionit bazë i cili është shprehje e veprimit të faktorëve monetarë. Inflacioni bazë është i ndikueshëm në mënyrë të paneglizhueshme nga agregati M1, pas një periudhe 12 –24 mujore. Ky përfundim lidhet me faktin që, fundvitet për periudhën në studim, janë shumë më të ndikueshëm se sa periudhat e tjera të vitit. Po kështu, përfundimet e prezantuara përforcojnë idenë se agregatët monetarë ndikojnë tek inflacioni për një periudhë nga 6 muaj deri në dy vjet.

Në një hap të dytë, kemi përdorur ekuacionin (2 dhe 3) për të përcaktuar nëse ndryshimet në normën e rritjes së agregatëve monetarë ndihmojnë për të parashikuar normën e inflacionit dhe e anasjellta. Rëndësia e kësaj faze ka të bëjë me një hap që duhet të paraprijë studimet e lidhjeve ndërmjet treguesve në procesin e parashikimit.

Në këtë rast, hipoteza zero është që të gjithë koeficientët Ψ_i dhe ρ_i janë të barabartë me zero. Në rast se pranojmë të kundërtën apo nëse bie poshtë hipoteza zero, atëherë mund të themi se paraaja (inflacioni) ndikon në ndryshimin e normës mujore të inflacionit (të parasë). Për këtë është aplikuar testi i Granger-it për regresin ndërmjet inflacionit dhe parasë (agregatëve monetarë) me vonesë kohore (ekuacioni 2) dhe e kundërta (në ekuacionin 3):

$$\Pi_t = \alpha + \sum_{i=1 \dots c} B_i \Pi_{t-i} + \sum_{i=1 \dots c} \Psi_i m_{t-i} + \varepsilon_t \quad (2)$$

$$m_{t-i} = \alpha + \sum_{i=1 \dots c} \xi_i m_{t-i} + \sum_{i=1 \dots c} \rho_i \Pi_{t-i} + \mu_t \quad (3)$$

ku,

m_{t-i} paraqet normën e rritjes të agregatit monetar në periudhën t-i dhe c është numri i kohëve vonesë (lag) të përdorura.

Sipas rezultateve, baza monetare shkakton (sipas testit Granger) normën e inflacionit. Ndërsa agregatët M1 dhe M3 shkaktojnë inflacionin bazë.

Por gjithashtu, edhe norma e inflacionit ndikon apo shkakton (sipas kriterit Granger) ndryshimin e M3, ndërkohë që inflacioni bazë nuk e bën këtë (shih tabela 4). Të dy treguesit, norma e inflacionit dhe ajo e inflacionit bazë shkaktojnë M1. Këto rezultate tregojnë se ekziston një lidhje e anasjelltë e shkak-pasojë ndërmjet inflacionit dhe agregatëve monetarë, fakt që duhet mbajtur parasysh në punën parashikuese.

Tabelë 4: Testi i Granger-it për lidhjet shkak-pasojë: Paraja me Inflacionin*.

	Baza Monetare		M1		M3	
	M→Π	Π→M	M→Π	Π→M	M→Π	Π→M
Norma e inflacionit	0.0124	0.4511	0.1782	0.0595	0.0808	0.0127
Inflacioni bazë	0.6269	0.0358	0.0197	0.0258	0.0002	0.4849

Shënim: *Vlerat e shprehura në tabelë janë probabilitetet sipas testit Granger, për të cilin nuk pranohet hipoteza e shkakësisë, kur $\alpha=0.05$.

5. KONKLUZIONE

Nga përvoja e bankave të tjera qendrore si edhe nga përfundimet për rastin e Shqipërisë, del e nevojshme matja e inflacionit bazë si një kategori domethënëse për vendimmarrjen në bankën qendrore.

Mënyra e sugjeruar e matjes është ajo e bazuar në metodën e mesatares së trimuar, sepse ajo jep rezultatet statistikisht më të mira. Kjo metodë, aplikohet në 70 për qind të artikujve të shportës. Megjithatë, gjykohet se metodologjia e matjes së inflacionit bazë, duhet të vijojë të përsoset në kohë, gjatë gjithë procesit të matjes së tij.

Procesi i implementimit të rregjimit të Inflation Targeting, duhet të mbajë në konsideratë, kategorinë e inflacionit mesatar (total dhe bazë) dhe jo vetëm atë të fundviteve. Studimi konkludon edhe një herë që, në mënyrë të veçantë është norma mesatare e inflacionit bazë më shumë e lidhur me agregatin monetar M1. Ky përfundim teston edhe matjen e kryer për inflacionin bazë, e cila tregon se seria e gjetur është komponentja e inflacionit që varet më drejtpërdrejtë nga politika monetare.

Rezultatet tregojnë se baza monetare ndikon (sipas testit Granger) mbi normën e inflacionit total, kurse agregatët M1 dhe M3 ndikojnë inflacionin bazë. Por, kjo lidhje duhet konsideruar me kujdes si në analizën e faktorëve ashtu edhe në parashikim: rezultatet nxjerrin në pah se ekziston një lidhje e anasjelltë shkak-pasojë ndërmjet inflacionit dhe agregatëve monetarë.

6. LITERATURË

Berkmen, "Measuring Core Inflation for Turkey - Trimmed Means Approach -", Central Bank of the Republic of Turkey (CBRT), Central Bank Review 2, 2002.

Blinder, "The Anatomy of Double - Digit Inflation in the 1970's", Chicago University Press, 1982.

Cecchetti, Stephen G., "Inflation Indicators and Inflation Policy", NBER Working paper, 1995, 5161.

Cecchetti, Stephen G., "Measuring inflation for central bankers", Federal Reserve Bank of St. Louis Review, nr. 79, 1997.

Cogley, Timothy, "A simple adaptive measure of core inflation", manuscript, Federale Reserve Bank of San Francisco, 1998.

Çeliku, "Kontributi i inflacioneve të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm në inflacionin total: rasti i Shqipërisë", Material Diskutimi, Nr.1(12)/03.

Gregory, Smith, "Measuring Business Cycles with Business-Cycles Models, Journal of Economic Dynamics & Control, 1996, 1007-1025.

Jacquinot, "L'inflation sous-jacente a partir d'une approche structurelle des VAR: Une application a la France, L'Allemagne et au Royaume - Uni", NER #51, 1998.

Kolasi, Çeliku, "Mekanizmi i transmisionit: Rasti i Shqipërisë", Konferenca III, Banka e Shqipërisë, dhjetor 2002.

Kolasi, "Inflacioni: Pse duhet të drithërohemi prej tij?", Monitor nr. 19 (21), shtator 2001.

McNeilly, Schiesser, "Reducing Inflation: Lesson from Albania's Early Success", WP/98/78, IMF Institute, May 1998.

Moron, Zegarra, "Measuring and Targeting Core Inflation in a Small, open and Dollarized Economy: The Peruvian Case", August, 1998

Quah, Vahey, "Measuring Core Inflation", the economic Journal, 1995, 105.

Vega, Wynne, "An Evaluation of Some Measures of Core Inflation for the Euro Area", ECB, Working Paper Series, Nr. 53, 2001.

Wynne, "Core Inflation: A Review of some conceptual issues", www.bis.org WP, nr. 5, April 1999.

Banka e Shqipërisë, "Raportet Vjetore, 2000, 2001, 2002, 2003, 2004".

SHËNIME

* Evelina Celiku: Nëndrejtoje, Departamenti i Kërkimeve.

Falenderoj, në mënyrë të vecantë, z.E. Luçi, z.G. Kolasi dhe znj. M. Peeters, për komentet e tyre të vlefshme në përgatitjen e këtij materiali.

Bashkëpunoi në seksionin 4: Gent Hashorva: Departamenti i Politikës Monetare.

Bashkëpunoi në punën voluminoze të përpunimit të të dhënave: zj.O. Minka: Departamenti i Kërkimeve.

¹ Ato gjenden në pothuajse të gjitha paketat statistikore dhe ekonometrike.

² Gregory & Smith (1996), Smith (1996) propozojnë një formë filtri shumë të përgjithshme që vlerësohet nga metoda e momenteve.

³ E. Çeliku "Inflacioni bazë dhe llogaritja e tij", prezantuar në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, korrik 2003.

⁴ Merr për bazë koeficientin e variancës për inflacionin bazë dhe koeficientin e korrelacionit ndërmjet inflacionit total dhe atij bazë.

⁵ Tabela është përshtatur, duke modifikuar apo duke shtuar informacion dhe komente, në lidhje me kriteret dhe me metodat - shënim i autorit.

⁶ Seria e inflacionit bazë dhe parashikimi për të, do të ishin jo të sakta, nëse filtri do të zgjidhej në mënyrë të gabuar.

⁷ Do të bëhet fjalë për përqindjen e përjashtuar të numrit të artikujve të listuar dhe jo për peshën e tyre në shportën që shërben për matjen e IÇK-së.

⁸ Peshat e lartë e qirasë së imputuar në grupin "Qira, energji, lëndë djegëse etj..", sillte deformime artificiale të indeksit të çmimeve të këtij grupi dhe të IÇK-së totale. Për më tepër që në këtë grup përfshihen energjia dhe uji, mallra me çmime të administruara. Kjo u vu në dukje vecanërisht në diskutimin e rezultateve të materialit "Inflacioni bazë dhe matja e tij", E. Çeliku, korrik 2003.

⁹ K muajt e ardhshëm dalin nga seria e faktuar e inflacionit, pra nuk janë pritjet për këtë tregues.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara të tij mund t'i kërkonte në adresën:

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 200 kopje